

FJALA E DEPUTETES HATIXHE KONOMI

E ENJTE 6 TETOR 2022

E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Së pari, nëse do të më lejoni të dal jashtë çështjes, meqenëse jemi në muajin tetor, i quajtur ndryshe edhe “Tetori rozë”, një muaj që i dedikohet tërësisht ndërgjegjësimit dhe sensibilizimit për kancerin e gjirit, si vajzë, grua e nënë, do të doja të shprehja solidaritetin më të lartë me të gjitha ato vajza e gra që përballen sot me këtë sëmundje, po ashtu të bëj thirrje që të gjitha ne të mos neglizhojmë, por të kuptojmë se sa i rëndësishëm është diagnostikimi i hershëm. Sa më shpejt, aq më pranë jetës!

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin, kthehem menjëherë te projektligji për të cilin do të kërkoja mbështetjen tuaj sot: projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes me shkëmbim notash ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Japonisë për zgjerimin e bashkëpunimit ekonomik dhe promovimit kulturor ndërmjet palëve përmes dhënies së grantit të ndihmës japoneze për projektin e përmirësimit të pajisjeve për ruajtjen, restaurimin dhe ekspozimin e mjedisit në Muzeun Historik Kombëtar të Shqipërisë”. Është më se i dukshëm tashmë angazhimi i qeverisë shqiptare për përmirësimin dhe zhvillimin e infrastrukturës kulturore në mbarë vendin. Vëmendja është rritur dita-ditës; kjo reflektohet në një sërë projektesh të rëndësishme, që janë vënë në jetë nga Ministria e Kulturës, pushteti lokal e donatorë të ndryshëm.

Do të doja, së pari, të veçoja zhvillimet mjaft pozitive në qytetin tim, qytetin muze të Beratit, i cili është një ndër qytetet më të pasura me objekte të trashëgimisë kulturore në vend dhe jo me kot që prej korrikut 2008 është pjesë e trashëgimisë botërore, duke u përfshirë në qytetet e mbrojtura nga UNESCO-ja. Sot panorama e objekteve të kulturës në Berat është krejt tjetër. Qytetarë e vizitorë shohin qartë se si ka ndryshuar kompleksi i Qendrës Mesjetare. Projekti i

restaurimit të dy objekteve të rëndësishme të kultit, xhamisë Mbret dhe teqesë së Helvetive dhe i mjedisit përreth tyre e kanë kthyer këtë qendër në një nga pikat turistike me të aksesueshme dhe me të vizituara të qytetit.

Po ashtu, restaurimi i xhamisë së Beqareve, restaurimi i kishës së Shën Mitrit, i kishës së Shën Joan Gojartit, i kishës së Shën Kollit, restaurimi i afreskut të kishës së Sinjës, i urës së Kasabashit, i urës së Vokopolës, restaurimi i mureve të kalasë, rrjeti i ri i ndriçimit të saj janë disa nga projektet e zbatuara gjatë dy vjetëve të fundit në Berat. Paralelisht me këto, Bashkia e Beratit po zbaton edhe disa projekte shumë të rëndësishme në infrastrukturën e lagjeve muzeale, siç janë: restaurimi i peizazhit historik urban të lagjes Goricë, restaurimi i peizazhit historik urban i lagjes Mangalem, restaurimi i peizazhit historik urban i sheshit të Selamllëkut, rigjenerimi i zonës përreth Muzeut Etnografik dhe rrugës “Mihal Komneno”. Këto janë projekte që do të nxjerrin edhe më në pah vlerat e jashtëzakonshme arkitekturore të siteve turistike të qytetit, duke e kthyer atë në një ndër qytetet kampion të turizmit në Shqipëri.

Ndërkohë, nuk mund të lë pa përmendur edhe mbështetjen financiare që Ministria e Kulturës dha nëpërmjet skemës “Bonusi i rijetësimit” për ata qytetarë që kishin në pronësi apo përdornin një objekt te qendra historike, ansambël historik urban, zonë arkeologjike apo monumente kulture jashtë tyre për t’i restauruar apo për t’i rijetësuar. Aktualisht, në Berat janë në proces 10 projekte rijetësimi me grande që variojnë nga 1-5 milionë lekë, duke u dhënë mundësi pronarëve për restaurimin dhe kthimin e objekteve brenda qendrave historike në modele të qëndrueshme biznesi, që gjenerojnë të ardhura e punësim për komunitetin. Për t’u kthyer te projektligji që po diskutojmë sot, pa dyshim që Muzeu ynë Historik Kombëtar është një ndër institucionet më të rëndësishme të kulturës në vend.

Që prej vitit 1981, vit në të cilin edhe u krijua, mbetet institucioni muzeor më i rëndësishëm që kemi, me rreth 7 pavijone, duke filluar me pavijonin e Lashtësisë, të Mesjetës, të Ikonografisë, të Rilindjes Kombëtare, Pavarësisë, etj. Në mjediset e muzeut janë rreth 6200 objekte, të cilat i përkasin një periudhe relativisht të gjatë kohore, duke filluar nga mijëvjeçari IV para Krishtit dhe deri në gjysmën e dytë të shekullit XX. Krahas sallave të pavijoneve, muzeu ka edhe mjediset e arkivit e të laboratorëve, salla të ekspozitave të përkohshme dhe salla konferencash. Muzeu

Historik Kombëtar është kthyer tashmë në një qendër shumëfunktionale. Numri i vizitorëve vendas e të huaj ka ardhur në rritje vit pas viti. Fondi i tij i pasur është një faktor që sjell numër të madh vizitorësh.

Në Muzeun Historik Kombëtar jo vetëm mirëpreiten vizitorë të shumtë, por organizohen edhe veprimtari përkujtimore për historinë e vendit, si dhe konferenca të mirëfillta shkencore I citova shumë shkurt disa të dhëna rreth Muzeut Historik Kombëtar për të theksuar faktin së ruajtja, restaurimi dhe mirëmbajtja e mjediseve të tij janë të një rëndësie të madhe. Jam e bindur që secili prej nesh mirëpret, duartroket e mbështet çdo iniciative konkrete me këtë fokus. Në këtë kuadër, diskutohet sot edhe ky projektligj për zgjerimin e bashkëpunimit ekonomik dhe promovimit kulturor përmes dhënies së grantit të ndihmës japoneze për projektin e përmirësimit të pajisjeve për ruajtjen, restaurimin dhe ekspozimin e mjedisit në Muzeun Historik Kombëtar të Shqipërisë.

Ky projekt do të sigurojë mjetet e nevojshme për përmirësimin e funksionimit të Muzeut Historik dhe për krijimin e kushteve të përshtatshme për përmirësimin e shërbimit ndaj publikut në ambientet e muzeut. Granti i vënë në dispozicion nga qeveria japoneze është deri në 145 300 mijë jenë japonezë. Pas përmirësimit të pajisjeve për ruajtjen, restaurimin dhe ekspozimin e mjedisit në Muzeun Historik Kombëtar të Shqipërisë, pajisjet e restauruara do të vijojnë të mirëmbahen me fondet e Muzeut Historik Kombëtar brenda tavaneve buxhetore të alokuara nga Ministria e Kulturës. Pajisjet e reja, që do të përfitohen nga zbatimi projektit, do të vijojnë të administrohen nga Muzeu Historik Kombëtar, në zbatim të ligjit nr.27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, për përmbushjen e detyrave të tij funksionale dhe rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj publikut.

Për sa u takon efekteve financiare, bëj me dije se zbatimi i ligjit nuk parashikon efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit. Komisioni për Politikën e Jashtme e shqyrtoi këtë projektligj në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi. Ky projektligj vjen në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”. Të gjithë në komision e mbështetëm unanimisht këtë marrëveshje, prandaj, kolegë, ju ftoj që edhe ju ta jepni këtë mbështetje, duke votuar pro këtij projektligji. Faleminderit!